



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

**PËR REFUZIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË TË DEPOZITUARA NGA PARTIA ALEANCA KUQ E ZI,
PJESTARE E KOALICIONIT "SHPRESA PËR NDRYSHIM", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për refuzimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë të paraqitura nga Partia Aleanca Kuq e Zi, pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Aleanca Kuq e Zi, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Aleanca Kuq e Zi, me vendimin e KQZ-së nr. 203, datë 23.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr. 273, datë 10.05.2019, është regjistruar koalicioni "Shpresa për Ndryshim", pjesë e të cilit është dhe Partia Aleanca Kuq e Zi.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.



Nr. 653 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për refuzimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë të paraqitura nga "Aleanca Kuq e Zi", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

KQZ, me vendimin nr. 494 datë 17.05.2019, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë Tiranë.

Partia Aleanca Kuq e Zi, nuk ka plotësuar dokumentacionin e plotë për regjistrim e listave shumemërore të kandidatëve për Këshillin e Bashkisë Tiranë, brenda afatit ligjor. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Partia Aleanca Kuq e Zi nuk ka depozituar në KQZ formularët e vetëdeklarimit për Këshillin e Bashkisë Tiranë. Referuar nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut II, pika 2, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 parashikohet se, "Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit".

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 73, pika 2, duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin Bashkisë Tiranë të Partisë Aleanca Kuq e Zi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 73, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkisë Tiranë pjesëtare të Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 653 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për refuzimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë të paraqitura nga "Aleanca Kuq e Zi", pjesëtare e Koalicionit "Shpresa për Ndryshim", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019